FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 32

Tiranë – E hënë, 28 shkurt 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 22/2022, datë 24.2.2022	Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"	3649
Vendim i Kuvendit nr. 23/2022, datë 24.2.2022	Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".....	3649
Vendim i Kuvendit nr. 24/2022, datë 24.2.2022	Për zgjedhjen e zotit Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.....	3650
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 22.2.2022	Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur.....	3650
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 153/3, datë 23.2.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i segmentit të kryqëzimit 'Ish-Kombinati 'Josif Pashko'–ish-'Uzina Dinamo e Re"".....	3656

VENDIM
Nr. 22/2022

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016, "PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË"

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit si më poshtë:

1. Yllka Rupa
2. Ilir Rusi

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 24.2.2022.

VENDIM
Nr. 23/2022

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016, "PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË"

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatin e listës së tretë për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit si më poshtë:

1. Mirela Bogdani

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 24.2.2022.

VENDIM
Nr. 24/2022

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT GENT SEJKO GUVERNATOR I BANKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 161 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Gent Sejko zgjidhet Guvernator i Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 24.2.2022.

UDHËZIM
Nr. 6, datë 22.2.2022

PËR REGJIMIN FISKAL NË SEKTORIN HIDROKARBUR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 3, neni 30, të ligjit nr. 153, datë 17.11.2020, "Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur", ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Qëllimi i udhëzimit

Qëllimi i udhëzimit është shpjegimi dhe qartësimi i dispozitave të ligjit nr. 153, datë 17.11.2020, "Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur", në mënyrë që regjimi fiskal në sektorin e hidrokarbureve të zbatohet në mënyrë uniforme.

1.2 Personat e tatueshëm

Neni 2 i ligjit përcakton se "person i tatueshëm", objekt i këtij ligji, janë personat juridikë që kryejnë operacione hidrokarbure në tokë (*onshore*). Për personat juridikë që mund të kryejnë operacione *offshore* në det, sistemi fiskal i zbatueshëm përcaktohet me ligj të veçantë.

Përveç personave juridikë që kryejnë operacione hidrokarbure dhe të cilët kanë kontratë me shtetin shqiptar, për efekt të trajtimit fiskal sipas këtij ligji, konsiderohen persona të tatueshëm edhe personat juridikë, të cilët megjithëse nuk kanë kontratë direkte me shtetin shqiptar, kryejnë direkt ose indirekt operacione hidrokarbure (të referuar si "nënkontraktorë"), në bazë të marrëveshjeve që kanë me kontraktorin. Trajtimi i "nenkontraktorëve", sipas dispozitave të ligjit nr. 153, datë 17.11.2020, "Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur", bëhet nëse ata plotësojnë një nga kriteret pikës 3, të nenit 2, të ligjit.

Sipas pikës 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 397/2021, "Për miratimin e rregullave të detajuara për personat juridikë nënkontraktorë që kryejnë operacione hidrokarbure", nëse niveli i kontributit të faturimit të bërë nga nënkontraktori, në lidhje me këto operacione, në totalin e shpenzimeve për operacionet hidrokarbure të personit të autorizuar është jo më i vogël se 25% e këtyre shpenzimeve, atëherë nënkontraktori i nënshtrohet regjimit fiskal për sektorin hidrokarbur, pra paguan tatim mbi fitimin me normë 50%.

Për këtë, kërkohet që nga kontraktori, për çdo vit ushtrimor, krahas deklaratës vjetore të tatim-fitimit dhe pasqyrave financiare brenda datës 31 mars, të depozitojë pranë organit tatimor një informacion ku të evidentohet vlera e blerjeve vjetore për secilin nënkontraktor, përqindja që ato zënë lidhur me totalin e shpenzimeve për operacionet hidrokarbure të vitit ushtrimor.

Ky informacion, njëkohësisht duhet t'i dërgohet edhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, e cila nga të dhënat që disponon sipas tremujorëve, e verifikon paraprakisht atë për përputhshmërinë dhe ja përcjell zyrtarisht organit tatimor.

Në këtë rast, llogaritja e shpenzimeve për operacionet hidrokarbure, nga nënkontraktori për kontraktorin, bëhet mbi bazën e vlerës totale në lekë të faturave të lëshuara nga nënkontraktori pa TVSH, në mënyrë akumulative për të gjithë

periudhën që nga data e fillimit të marrëveshjes ndërmjet kontraktorit dhe nënkontraktorit.

Shembull. Nëse kontrata ndërmjet kontraktorit dhe nënkontraktorit zgjat 3 vjet dhe është lidhur në vitin "1" atëherë.

Për vitin "1" llogaritja e nivelit të shpenzimeve mbi apo nën kufirin 25% do të bëhet duke krahasuar:

- Faturimet në lidhje me operacionet hidrokarbure të nënkontraktorit për kontraktorin në vitin 1, me
- Shpenzimet e operacioneve hidrokarbure të kontraktorit në vitin 1.

Për vitin "2" llogaritja e nivelit të shpenzimeve mbi apo nën kufirin 25% do të bëhet duke krahasuar:

- Faturimet në lidhje me operacionet hidrokarbure të nënkontraktorit për kontraktorin në vitet 1+2, me
- Shpenzimet e operacioneve hidrokarbure të kontraktorit në vitet 1+2.

Për vitin "3" llogaritja e nivelit të shpenzimeve mbi apo nën kufirin 25% do të bëhet duke krahasuar:

- Faturimet në lidhje me operacionet hidrokarbure të nënkontraktorit për kontraktorin në vitet 1+2+3, me
- Shpenzimet e operacioneve hidrokarbure të kontraktorit në vitet 1+2+3.

1.3 Vendosja e rentës minerare

Neni 5 i ligjit përcakton dhe rregullon aplikimin e rentës minerare për hidrokarburet, mënyrën e llogaritjes, si dhe rastet kur nuk aplikohet renta.

Mbajtësi i një të drejte hidrokarbure duhet të paguajë rentë minerare për të gjitha hidrokarburet që nxirren në bazë të së drejtës. Renta minerare që llogaritet në të tilla raste, aplikohet me normën 10% të vlerës së tregut të hidrokarbureve (naftë dhe gaz) të nxjerra në territorin e Republikës së Shqipërisë.

II. TATIMI MBI FITIMIN PËR OPERACIONET HIDROKARBURE

2.1 Aplikimi i tatimit mbi fitimin

Në nenin 7 përcaktohet aplikimi i tatimit mbi fitimin për personat e tatueshëm në bazë të këtij ligji.

Një person që kryen operacione hidrokarbure i nënshtrohet tatimit mbi fitimin të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, por mbi një bazë të veçantë tatimore dhe me një normë të veçantë për sa i takon operacioneve hidrokarbure të përcaktuara sipas këtij ligji. Fitimet e tatueshme të një personi nga operacionet hidrokarbure llogariten dhe tatohen sipas dispozitave të këtij ligji, ndërsa fitimet e tatueshme të atij personi nga operacionet johidrokarbure llogariten dhe tatohen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

Kontraktorët dhe nënkontraktorët janë përgjegjës për llogaritjen e tatimit mbi fitimin mbi një bazë të rregullt tatimi dhe në normën e rregullt tatimore që duhet të zbatohet sipas ligjit 'Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve", për operacionet hidrokarbure, dhe sipas ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", për operacionet johidrokarbure.

Të ardhurat dhe shpenzimet që krijohen, rrjedhin dhe/ose shkaktohen nga kryerja e aktivitetit ndahen ndërmjet operacioneve hidrokarbure dhe atyre johidrokarbure, në mënyrë të
tillë që të mos ketë mbivendosje.

Tatimi mbi fitimin nga operacionet hidrokarbure për një periudhë tatimore llogaritet duke aplikuar shkallën tatimore 50% të fitimit të tatueshëm nga operacionet hidrokarbure, për këtë periudhë.

Për qëllime të llogaritjes së fitimeve të tatueshme nga operacionet hidrokarbure:

a) çdo operacion i veçantë hidrokarbur trajtohet si një biznes i pavarur dhe personi duhet t'i mbajë të dhënat financiare për këtë biznes të ndara nga çdo aktivitet tjetër ekonomik i tij;

b) personi duhet të llogarisë fitimin e tatueshëm, humbjen dhe detyrimin e tatimit mbi fitimin për biznesin në mënyrë të pavarur për çdo periudhë tatimore. Pra, kontraktorët e operacioneve hidrokarbure duhet të llogarisin detyrimin ndaj tatimit mbi fitimin në mënyrë të ndarë për secilin nga operacionet hidrokarbure që ata zhvillojnë.

Në nenin 8 të ligjit përcaktohen operacionet e veçanta hidrokarbure, ndërkohë, udhëzimi i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 21, datë 14.7.2021, "Për operacionet e veçanta hidrokarbure dhe parashikimet financiare", detajon zbatimin e këtij neni.

2.2 Fitimet e tatueshme dhe humbjet e lejuara

Në nenin 9 përcaktohet mënyra e llogaritjes së fitimeve të tatueshme nga një operacion i veçantë

hidrokarbur. Qëllimi i sistemit të izoluar (*ring fence*) është të sigurojë që shpenzimet dhe humbjet nga një operacion i veçantë hidrokarbur nuk kompensojnë të ardhurat nga një operacion tjetër i ndarë hidrokarbur. Gjithashtu, shpenzimet dhe humbjet nga operacionet johidrokarbure nuk mund të kompensojnë të ardhurat nga operacionet hidrokarbure dhe anasjelltas. Ligji përcakton se për një operacion të veçantë hidrokarbur, shpenzimet dhe humbjet mund të reduktojnë të ardhurat në një maksimum prej 85% të tyre. Kjo metodë ka funksion të ngjashëm me kufirin e rikuperimit të kostos në marrëveshjet hidrokarbure, duke siguruar kështu një tatim-fitimi minimal vjetor të marrë nga sasia e hidrokarbure të nxjerra. Pra, fitimi i tatueshëm i periudhës llogaritet duke zbritur nga të ardhurat, shpenzimet e zbritshme dhe humbjet e lejuara, me kusht që zbritja të mos kalojë 85% të të ardhurave nga operacioni i veçantë hidrokarbur.

Nëse shpenzimet e zbritshme, të përcaktuara në nenin 11, do të tejkalojnë 85% të të ardhurave të periudhës, atëherë pjesa e shpenzimeve që tejkalojnë 85% të të ardhurave lejohet që të mbartet si humbje për periudhat e tjera. Këto humbje të lejuara mund të mbarten për një periudhë të pacaktuar duke u përdorur për të zvogëluar fitimet e tatueshme.

Humbja e lejuar nga një operacion i veçantë hidrokarbur, për një periudhë tatimore të caktuar, është masa në të cilën shpenzimet e zbritshme të operacionit për periudhën tejkalojnë 85% të të ardhurave nga ky operacion për këtë periudhë.

Shembull. Supozojmë se shpenzimi i zbritshëm i një operacioni hidrokarbur, në periudhën tatimore përkatëse, përbën 60% të totalit të të ardhurave të së njëjtit operacion hidrokarbur, dhe humbjet e lejuara të viteve të mëparshme, të po të njëjtit operacion hidrokarbur, përbëjnë 35% të totalit të të ardhurave të këtij operacioni. Shpenzimet e periudhës do të njihen si të zbritshme plotësisht në këtë periudhë, ndërkohë që nga humbja e lejuar e periudhave të mëparshme, në këtë periudhë tatimore, do të njihet si e zbritshme vetëm 15% e saj, ndërkohë që pjesa tjetër prej 20% është humbje e palejuar për periudhën tatimore në fjalë, dhe do të kalojë si humbje e mbartur për periudhën pasardhëse.

Në nenet 10, 11 dhe 12 parashikohen të ardhurat nga operacionet hidrokarbure dhe shpenzimet që janë të zbritshme nga të ardhurat. Shpenzimet e zbritshme janë specifikuar, por lidhja e tyre me një operacion të caktuar hidrokarbur do të përcaktohet edhe duke iu referuar programit të punës për operacionin.

Gjithashtu, këto dispozita përcaktojnë se rregullat e transferimit të çmimit, të përcaktuara nga ligji i tatimit mbi të ardhurat, zbatohen pa kufizime juridiksionale në operacionet hidrokarbure.

Baza e tatueshme për operacionet hidrokarbure është e ndryshme nga baza e tatueshme e zakonshme e llogaritjes së tatimit mbi fitimit, sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat. Kjo, pasi shpenzimet kapitale (përveç shpenzimeve operative) në operacionet hidrokarbure janë menjëherë të zbritshme në periudhën kur ndodhin, ose mbarten në periudhën/periudhat pasardhëse nëse kalohet kufiri i shpenzimeve prej 85%. Pra në operacionet hidrokarbure amortizimi nuk lejohet, ndërkohë që shpenzimet e financimit nuk janë të zbritshme.

2.3 Marrja, heqja dorë, transferimi nga një e drejtë hidrokarbure

Neni 14 sqaron se marrja, mbajtja dhe heqja dorë nga një e drejtë hidrokarbure nuk është pjesë e operacioneve hidrokarbure. Kjo e drejtë konsiderohet si pjesë e operacioneve johidrokarbure të mbajtësit të së drejtës dhe për të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar. Pra, nëse një kontraktues e shet të drejtën (qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet një shoqërie të lidhur ndërmjetësuese) me fitim, fitimi i nënshtrohet tatimit të fitimit sipas normës tatimore 15%. Kjo mund të ndodhë kur një kontraktues zbulon hidrokarbure, por shet të drejtën para nxjerrjes së tyre. Përgjithësisht, në këto raste, fitimi në dispozicion të së drejtës reflekton kryesisht hidrokarburet që parashikohet të nxirren. Nëse do të tatohej me normë tatimore 50% fitimi nga shitja e së drejtës, dhe më pas do të tatohej po me 50% fitimi nga nxjerrja e hidrokarbureve, kjo do të përbënte tatim të dyfishtë.

Blerësi i një të drejte hidrokarbure lejohet të zhvlerësojë koston e blerjes së të drejtës në normën prej 5%, gjatë një periudhe 20-vjeçare. Megjithatë, duke qenë jashtë "zonës së rrethimit", zhvlerësimi është i lejueshëm vetëm për të zvogëluar fitimet nga operacionet johidrokarbure.

Shpenzimet për pagesat e interesit, kostot financiare dhe kostot e shkaktuara në lidhje me

instrumentet financiare, përfshirë shumat zëvendësuese për interesin ose të trajtuara si kosto financimi nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, nuk janë shpenzime të zbritshme për operacionet hidrokarbure, por deri në masën që ato i atribuohen një të drejte hidrokarbure.

Nëse kontraktori realizon njëkohësisht operacione hidrokarbure dhe operacione johidrokarbure, shpenzimet e trajtuara në paragrafin më sipër, do të njihen si shpenzim i zbritshëm i operacioneve johidrokarbure, deri në atë masë sa është përqindja e të ardhurave të operacioneve johidrokarbure në totalin e të ardhurave të kontraktorit nga të gjitha operacionet hidrokarbure dhe johidrokarbure. Shembull. Nëse nga totali i të ardhurave nga e gjithë veprimtaria, të ardhurat nga operacionet hidrokarbure janë 70%, ndërsa nga operacionet johidrokarbure janë 30%, shpenzimet e interesit dhe kostot financiare sipas paragrafit të mësipërm do të jenë të zbritshme nga të ardhurat e operacioneve johidrokarbure, vetëm në masën 30% të totalit të tyre, ndërsa diferenca 70% e shpenzimeve të tilla, nuk është e zbritshme as nga të ardhurat e operacioneve hidrokarbure, as nga të ardhurat e operacioneve johidrokarbure.

Neni 15, paraqet rregulla veprimi në lidhje me disa nga aspektet më teknike të operacioneve hidrokarbure, siç janë ato të transferimit të të drejtave hidrokarbure. Veçanërisht, ai trajton marrëveshjet "*farm out*", të cilat në mënyrë tipike përfshijnë shitjen e një pjese të interesit në një operacioni hidrokarbur në këmbim të një premtimi nga blerësi për të përballuar shpenzime, për transferuesin në të ardhmen. Një metodë e vlerës aktuale përdoret për të siguruar që shitja me "*farm out*" i nënshtrohet menjëherë tatimit.

Neni 16, paraqet dispozita të përshtatshme për rehabilitimin dhe çmontimin e operacioneve hidrokarbure, duke siguruar një zbritje për kontributet nga një kontraktor në një fond rehabilitimi të aprovuar (që është përtej kontrollit të kontraktuesit).

III. MARRËVESHJET HIDROKARBURE

3.1 Detyrimi për marrjen në konsideratë të marrëveshjeve hidrokarbure

3.1.1 Marrëveshjet hidrokarbure të miratuara para hyrjes në fuqi të ligjit

Neni 17 i ligjit synon të bëjë dallimin e rëndësishëm midis marrëveshjeve ekzistuese hidrokarbure, të miratuara me VKM para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 153, datë 17.11.2020, "Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur", për të cilat do të merren në konsideratë dhe do të zbatohen klauzolat fiskale, dhe stabiliteti tatimor i parashikuar në këto marrëveshje, dhe marrëveshjeve që mund të miratohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të cilat do të zbatohen klauzolat e parashikuara në këtë ligj së bashku me ato të stabilitetit të parashikuar në marrëveshje, nëse do të ketë të tilla.

Për marrëveshjet hidrokarbure (apo amendimet e tyre), të cilat janë miratuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, administrata tatimore zbaton klauzolat e parashikuara në këto marrëveshje për mbrojtjen specifike që këto marrëveshje përmbajnë, në lidhje me tarifat tatimore, kompensimet, apo çdo përjashtim fiskal të parashikuar në këto marrëveshje për personat që kanë të drejtë të kryejnë operacione hidrokarbure, sipas dispozitave të marrëveshjes.

3.1.2 Marrëveshjet hidrokarbure të miratuara pas hyrjes në fuqi të ligjit

Në rastin e një marrëveshjeje hidrokarbure ose ndryshimit të saj, të miratuar pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, administrata tatimore duhet të zbatojë legjislacionin fiskal në fuqi, por duke respektuar klauzolat e miratuara të stabilitetit të regjimit fiskal të parashikuara në këto marrëveshje, siç sqarohet nga neni 18 i ligjit, si dhe lehtësimet nga taksat/tarifat vendore të parashikuara në marrëveshje, siç përcaktohet në nenin 19 të këtij ligji.

Pra, situata është e ndryshme në lidhje me marrëveshjet e reja hidrokarbure. Administrata tatimore zbaton të dyja dispozitat në marrëveshjet e reja: klauzolat e miratuara të stabilitetit fiskal sipas nenit 18 dhe lehtësimin nga taksat vendore, sipas nenit 19.

Nëse marrëveshja do të ketë klauzolë të stabilitetit të regjimit fiskal ose ndryshim në të, që përfshin mbrojtjen sipas shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 18, ajo pushon së qeni një klauzolë e miratuar e stabilitetit të regjimit fiskal 12 (dymbëdhjetë) vjet nga data e fillimit të prodhimit, sipas marrëveshjes hidrokarbure.

3.2 Lehtësimi nga taksat vendore dhe taksat e tjera

Në nenin 19 të ligjit përcaktohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të zbatojnë lehtësim

nga taksat/tarifat vendore, të cilat janë parashikuar në marrëveshjet hidrokarbure.

3.3 Shmangia e përfitimeve të dyfishta nga marrëveshjet hidrokarbure

Në nenin 20 të ligjit përcaktohet se një palë në një marrëveshje hidrokarbure nuk mund të pretendojë përfitime të dyfishta nga marrëveshjet hidrokarbure. Pra, nuk mund të pretendojë njëkohësisht një mbrojtje specifike apo përjashtim/lehtësim sipas marrëveshjes, në lidhje me legjislacionin fiskal, si dhe në të njëjtën kohë përfitime nga ndryshimet lehtësuese në legjislacionin fiskal, që ndodhin pas miratimit të marrëveshjes hidrokarbure. Pra, p.sh. nëse në marrëveshjen hidrokarbure ka klauzolë stabiliteti fiskal dhe është parashikuar pagesa e rentës minerare me normën 10 %, kontraktori hidrokarbur do të vazhdojë ta paguajë rentën minerare sipas kësaj norme edhe nëse shteti shqiptar, për qëllime të tjera që nuk kanë të bëjnë me këtë marrëveshje, në vitet në vijim, e ul normën e rentës në 5%, ose e rrit atë në 15%. Nëse në marrëveshje nuk është parashikuar klauzolë stabiliteti fiskal, do të zbatohet në çdo rast legjislacioni fiskal në fuqi.

IV. ADMINISTRIMI

Nenet 22 dhe 23 përcaktojnë rregulla standarde për paraqitjen e deklarimeve dhe pagesën e rentës, dhe tatimit mbi fitimin.

4.1 Deklarata tatimore dhe pagimi i rentës, dhe tatimit mbi fitimin për operacionet hidrokarbure

Në nenin 22 përcaktohet mënyra dhe afati i deklarimit, dhe i pagesës së rentës minerare, si dhe përmbajtja e deklaratës tatimore dhe e rentës minerare. Afati për kryerjen e pagesës së rentës minerare për hidrokarburet e nxjerra gjatë një muaji kalendarik është brenda datës 15 (pesëmbëdhjetë) të muajit të ardhshëm kalendarik dhe kryhet nga mbajtësi i të drejtës hidrokarbure.

Deklarimi bëhet në përputhje me modelin e miratuar të deklaratës që i bashkëlidhet këtij udhëzimi: "Formulari i deklarimit të rentës për hidrokarburet". Kur subjekti mbajtës i së drejtës hidrokarbure eksporton mineralin hidrokarbur, renta minerare paguhet në degët doganore, në çastin e plotësimit të deklaratës doganore të eksportit.

Sipas nenit 23, nëse një person kryen njëkohësisht edhe operacione hidrokarbure edhe operacione johidrokarbure, ai duhet të paraqesë më vete një deklaratë tatimore për operacionet hidrokarbure të kryera nga ai dhe një deklaratë tjetër tatimore për operacionet johidrokarbure. Personi në këto raste duhet të ndajë veprimtarinë në fushën e operacioneve hidrokarbure, me NIPT më vete, nga veprimtaria tjetër që mund të kryejë. Kjo bëhet me qëllim që të aplikojë shkallën e tatim-fitimit 50% për operacionet hidrokarbure, sipas këtij ligji, dhe shkallën e tatimit 15% për operacionet johidrokarbure, sipas ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat".

Shembull. Nëse një person kryen operacione hidrokarbure të nxjerrjes së naftës, por njëkohësisht, i njëjti person ka rafineri për përpunimin dhe prodhimin e nënprodukteve të naftës, ai duhet t'i ndajë këto dy veprimtari dhe t'i regjistrojë me NIPT-e të ndryshme, si dhe të deklarojë veçmas për këto dy veprimtari.

4.2 Koordinimi me autoritetin rregullator dhe parashikimet financiare

Neni 25 parashikon që administrata tatimore duhet të punojë në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin rregullator në administrimin e këtij ligji. Për këtë qëllim, administrata tatimore dhe autoriteti rregullator ndajnë informacione të tilla që lidhen në mënyrë të parashikueshme me funksionet e tyre përkatëse dhe mund të kryejnë kontrolle të përbashkëta.

Në nenin 26 parashikohet detyrimi i mbajtësit të së drejtës hidrokarbure për të përgatitur parashikime financiare, periudha dhe afatet e raportimit të parashikimeve. Udhëzimi i përbashkët i ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për hidrokarburet nr. 21, datë 14.7.2021, "Për operacionet e veçanta hidrokarbure dhe parashikimet financiare", detajon zbatimin e këtij neni.

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare. "Formulari i deklarimit të rentës për hidrokarburet", bashkëlidhur udhëzimit fillon efektet më datë 1.5.2022.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

FORMULARI I DEKLARIMIT TË
RENTËS PËR HIDROKARBURET

Numri i Vendosjes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT):	(3)
Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm:	(4)
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	(5)
Adresa: Qyteti/Komuna/Rrethi:	(6)
Numri Telefonit:	

Lajmëroni nëse informacioni është jo i plotë ose kandryshuar

(7) Shënoni "x" nëqoftëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion

I. SHITJE BRËNDA VENDIT

	Sasia e taksueshme	Totali i shumës
1.1 Naftë bruto [8;9];	[8]	[9]
1.2 Gaz [10;11]	[10]	[11]
1.3 Renta për nxjerrjen e naftës bruto [12]	Renta e llogaritur	
	[12]	
1.4 Renta për nxjerrjen e gazit [13]	Renta e llogaritur	
	[13]	

TOTALI PËR TU PAGUAR [14]

II. EKSPORTE
(deklarim per organet doganore)

	Sasia e taksueshme	Totali i shumës së Eksportuar
1.5 Eksport Naftë bruto [15;16]	[15]	[16]
1.6 Eksport Gaz [17;18]	[17]	[18]

	Renta e llogaritur
1.7 Renta për eksportin e naftës bruto [19]	[19]
	Renta e llogaritur
1.8 Renta për eksportin e gazit [20]	[20]

TOTALI PER TU PAGUAR NË EKSPORT [21]

PAGESA (14+21) [22]

,- Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

KËRKESË
Nr. 153/3, datë 23.2.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i segmentit të kryqëzimit 'Ish-Kombinati 'Josif Pashko'–ish-'Uzina Dinamo e Re"".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasuritë e llojit "truall", si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", për pasuritë e llojit "Ndërtesë banimi ose jobanimi", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 3,524,632.8 (tre milionë e pesëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy pikë tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I SEGMENTIT TË KRYQËZIMIT 'ISH-KOMBINATI 'JOSIF PASHKO'–ISH-'UZINA DINAMO E RE""

Nr.	Pronari		Të dhëna hipotekore									Vlerësimet për shpronësim							Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë)
												Truall			Ndërtesë			Vlera totale (lekë)	
	Emri	Atësia	Fshati ose qyteti	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m^2)	Ndërtesë (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
1	**Qazim**	**Dajlan**	**Tiranë**	8330	1/451	Truall	127.5	127.5	63	15	220	54.6	34068	1,860,112.8	0	0	-	1,860,112.8	
2	**Muhamet**	**Rexhep**	**Tiranë**	8330	1/170-ND	Ndërtesë	56.9	0	56.9	19	47	0	0	-	20	83226	1,664,520.0	1,664,520.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "Përshkrimi i veçantë", ka shënimin: "Nuk ka marrëdhënie me truallin. Kartela e vlefshme për blerjen e truallit". Në seksionin "D" ka shënimin "Bllokohet prona në favor të Fondit për shumën 300000 lekë k. hip. 2611/1417, datë 25.9.2014, not. M. Yefi". Në seksionin "C" ka shënimin "Shteti është pronar i truallit 1/170, vol. 24 f. 233, mbi të cilin ndodhet ndërtesa 1/170-ND". VO: Në lidhje me funksionin e ndërtesës bazohemi në faktin që me shkresën nr. prot. 33851/1, datë 12.10.2018, ZVRPP Tiranë ka sjell vendim gjykate ku gjejmë funksionin e ndërtesës që është banesë.
3	Shtet		Tiranë	8330	1/740	Truall	145	145	0	22	151	139	0	-	0	0	-	0.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E", ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Bedri Beqir Halili. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
4	Shtet		Tiranë	8330	1/744	Truall	91	91	0	22	155	68.9	0	-	0	0	-	0.0	Në seksionin "E", ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Qazim Dajlan Shaqe.".
5	Shtet		Tiranë	8330	1/748	Truall	285	285	0	22	159	17	0	-	0	0	-	0.0	Në seksionin "E" ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Selman Llesh Dapa. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
6	Shtet		Tiranë	8330	1/749	Truall	70	70	0	22	160	47	0	-	0	0	-	0.0	Në seksionin "E" ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Dritan Rexhep Meta. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
7	Shtet		Tiranë	8330	1/750	Truall	100	100	0	22	161	100	0	-	0	0	-	0.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E", ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Beqir Ahmet Kurtaj. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
8	Shtet		Tiranë	8330	1/751	Truall	159	159	0	22	162	100	0	-	0	0	-	0.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E", ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Ylli Sadik Merja. Ka një ndërtim të paligjshëm.".

9	Shtet	Tiranë	8330	1/756	Truall	60	60	0	22	167	38	0	-	0	0	-	0.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E", ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Fatmir Lleshi. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
10	Shtet	Tiranë	8330	1/158	Truall	341	341	0	24	221	178	0	-	0	0	-	0.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E", ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Mevlud Isof Conii. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
11	Shtet	Tiranë	8330	1/165	Truall	134	134	0	24	228	64	0	-	0	0	-	0.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E", ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Xhafer Nezir Stafa. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
12	Shtet	Tiranë	8330	1/166	Truall	191	191	0	24	229	129	0	-	0	0	-	0.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E", ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Shkurt Ali Dervishi. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
13	Shtet	Tiranë	8330	1/167	Truall	180	180	0	24	230	127	0	-	0	0	-	0.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E", ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Niko Panajot Kocos. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
14	Shtet	Tiranë	8330	1/169	Truall	151	151	0	24	232	84	0	-	0	0	-	0.0	Në seksionin "E" të kartelës ka shënimin: "Kjo pasuri është e okupuar nga Maksim Jorgji Zoraqi. Ka dy ndërtime të paligjshme.".
15	Shtet	Tiranë	8330	1/170	Truall	360	360	0	24	233	290	0	-	0	0	-	0.0	Në seksionin "D" ka shënimin: "Muhamet Rexhep Cenaliu është pronar i pasurisë 1/170-ND, ndërtesë vol. 19, f. 47, mbi truallin 1/170".
16	Shtet	Tiranë	8330	1/145	Truall	967	967	0	24	213	82	0	-	0	0	-	0.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E", ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Adnan Bedri Halili. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
17	Shtet	Tiranë	8330	1/146	Truall	845	845	0	24	214	24	0	-	0	0	-	0.0	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "D", ka shënimin: mbi truallin e pasurisë nr. 1/146, pozicionohet pasuria nr. 1/1164/ND, vol. 48, f. 32". Në seksionin "E" ka shënimin: "Kjo pasuri është okupuar nga z. Agron Osman Boka. Ka një ndërtim të paligjshëm.".
	Total										**193.6**		**1,860,112.8**	**20**		**1,664,520.0**	**3,524,632.8**	

1. Për truallin çmimi i llogaritur është marrë nga VK-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

2. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën nr. prot. 8080/2, datë 21.10.2021, protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me shkresën nr. prot. 23722/5, datë 22.10.2021.

3. Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar i llogaritur bazuar në kontratat e shitblerjeve për objekt banimi, vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 8080/2, datë 21.10.2021, protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me shkresën nr. prot. 23722/5, datë 22.10.2021.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 32
Datë: 2022/02/28 17:09:34
0d19abbc-4faf-47ac-934c-7b4365f0060f

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë